

## Përmbledhje

- **Ekonomia e eurozonës** vazhdoi të ndikohet nga zhvillimet gjeopolitike të ndërlidhura me luftën në Ukrainë, specifikisht, dobësimi i aktivitetit ekonomik, presionet inflacioniste dhe shtrëngimi i politikës monetare, dinamika që kanë dobësuar kapacitetin ripagues të borxhit të ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve. Në tremujorin e tretë të vitit 2022, ekonomia e eurozonës ka shënuar rritje prej 2.1 përqind, rritje kryesisht e mbështetur nga kërkesa e brendshme. **Norma e lartë e inflacionit në eurozonë** ka vazhduar trendin e rritjes, ku çmimet e energjisë dhe ushqimit mbesin kontribuuesit kryesorë. Në vitin 2023, aktiviteti ekonomik në eurozonë pritet të ngadalësohet si pasojë e vazhdimet të presioneve inflacioniste dhe shtrëngimit të kushteve të financimit. Rënia e aktivitetit ekonomik në eurozonë dhe luhatjet në çmime në tregjet ndërkombëtare pritet të reflektohen në dinamikat e përgjithshme ekonomike të vendeve në **Ballkanin Perëndimor, ku BPV** në TM3 2022 vlerësohet të jetë ngadalësuar përgjithësisht.
- **Rritja reale e Bruto Produktit Vendor (BPV)** në Kosovë në TM3 2022 ishte pozitive, ndonëse relativisht më e ulët krahasuar me tremujorin paraprak. Rritja ekonomike u mbështet nga kërkesa e brendshme, gjegjësisht konsumi privat dhe publik, eksporti i shërbimeve, si dhe nga rënia në importin e mallrave, ndërsa ndikim negativ patën niveli i ulët i investimeve dhe importi i rritur i shërbimeve. Trend i ngjashëm i rritjes ekonomike pritet edhe në tremujorin vijues, si pasojë e ndikimit të presioneve inflacioniste në fuqinë blerëse dhe rrjedhimisht në kërkesën e brendshme, ndërkohë që tregtia e jashtme pritet të mbështesë dukshëm rritjen ekonomike bazuar në pritjet për rritje të eksportit të shërbimeve dhe rënie të importit të mallrave.
- **Inflacioni** në vend vazhdoi të nxitet nga luhatjet e çmimeve të energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, shpërndarja e presioneve inflacioniste në sektorë tjerë ka bërë që baza e inflacionit të zgjerohet tutje duke ndikuar kështu edhe në ngritjen e inflacionit të brendshëm. Sinjalet pozitive nga tregjet ndërkombëtare sa i përket çmimeve të energjisë dhe ushqimit, si dhe rritja më e ngadalëshme e pritur e konsumit, pritet të përkthehen në zbutjen e presioneve inflacioniste në tremujorin vijues, megjithëse pasiguritë e larta po vazhdojnë të karakterizojnë ambientin makroekonomik në nivel global.
- **Llogaria rrjedhëse** në TM3 2022 shënoi bilanc pozitiv prej 157.5 milionë euro, kryesisht si rezultat i numrit më të lartë të ardhjes së diasporës, gjë që ka ndikuar në rritjen e bilancit të shërbimeve ndërkohë që edhe remitencat e pranuar shënuan rritje të përshpejtuar. Në anën tjetër, bilanci i mallrave, i ndikuar nga rritja e çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare, kishte ndikim negativ në llogarinë rrjedhëse. Edhe IHD-të rezultuan të jenë rritur me ritëm të përshpejtuar, dinamikë që mund t'i atribuohet deri në një masë rritjes së çmimeve të inputeve në ndërtimtari, duke qenë se pjesa më e madhe e IHD-ve është e koncentruar në patundshmëri (rreth 70 përqind).
- **Buxheti i Kosovës** shënoi bilanc primar buxhetor prej 117.4 milionë euro në TM3 2022, si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave buxhetore krahasuar me shpenzimet, ndërsa borxhi publik ra në 20.5 përqind të BPV-së.
- **Sistemi financiar** është karakterizuar me qëndrueshmëri dhe pa ndonjë rrezik të materializuar gjatë TM3 2022, përkundër shqetësimeve rreth ngadalësimit ekonomik, presioneve inflacioniste dhe pasigurive të rritura në tregjet ndërkombëtare.
  - **Sektori bankar** ka arritur të mbaj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit si dhe të mirëmbajë nivel të ulët të kredive jo performuese, gjë që rezultoi të jetë përkthyer në rritje të kapacitetit absorbues të sektorit ndër vite. Ndërkohë që vlerësohet se shkalla e lartë e inflacionit përgjatë gjithë vitit ka ndikuar në uljen potenciale të të ardhurave të disponueshme në ekonomi, duke rrezikuar potencialisht kapacitetin ripagues të huamarrësve (rritje potenciale e rrezikut kreditor) dhe dekurajuar kursimet (rrezikun e likuiditetit), të dhënat në nëntë muajt e parë të vitit 2022 nuk tregojnë për materializim të këtyre rreziqeve në aktivitetin dhe performancën e sektorit. Në TM3 2022, aktiviteti kreditues ishte kontribuuesi kryesor pozitiv në rritjen e aseteve të sistemit financiar, përderisa investimet në letrat me vlerë shënuan ngadalësim të rritjes. Pasiguria e shtuar nga rritja e çmimeve në vend dhe globalisht, zhvillim që përkoi me ngadalësimin e rritjes së depozitave në këtë tremujor, shtyu sektorin bankar të ofrojë kushte më të favorshme për sigurimin e financimit.
  - **Sektori pensional** shënoi ngadalësim të rritjes dhe rënie të kthimeve nga investimet krahasuar me një vit më parë, kryesisht si pasojë e dinamikave jo të favorshme në tregjet financiare ndërkombëtare. Përderisa vlera e kontributeve të arkëtuara shënoi rritje në të dy fondet pensionale, kthimi në investime pësoi rënie të vlerës.
  - **Sektori i sigurimeve** u karakterizua me nivel të përfaqshëm të rritjes së aseteve me vitin paraprak, të favorizuar nga niveli i lartë i primeve të arkëtuara. Megjithatë, rritja e përshpejtuar e dëmeve të ndodhura rezultoi në një performancë financiare më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak.
  - Me rritje të përshpejtuar të aseteve u karakterizua **sektori mikrofinanciar**, atribuar kryesisht rritjes së aktivitetit kreditor. Indikatorët e shëndetit financiar gjithashtu tregojnë për stabilitet të sektorit në përgjithësi, ndërkohë që rezultati financiar rezultoi të jetë më i larti që nga konsolidimi i sektorit. Në periudhat në vijim, dinamikat e rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare pritet të reflektohen në rritjen e kostove të financimit për sektorin mikrofinanciar.

Përmbajtja	
Përmbledhje .....	0
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor .....	2
<b>Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare .....</b>	<b>2</b>
Ekonomia e Kosovës .....	4
Rritja Ekonomike .....	4
Çmimet .....	5
Sektori Fiskal.....	8
Sektori i jashtëm.....	9
Sistemi financiar .....	12
1. Sektori bankar .....	12
1.1. Detyrimet dhe burimet vetanake .....	15
1.2 Normat e interesit.....	16
Sektori pensional.....	19
Sektori i sigurimeve .....	20
Sektori mikrofinanciar .....	21
Kreditë Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar shënoi rritje të përshpejtuar duke iu afruar nivelit të rritjes së kreditimit në periudhën para pandemike.....	22
Performanca e sektorit mikrofinanciar .....	23
Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës .....	24

## Eurozona dhe Ballkani Perëndimor


**Ekonomia e Eurozonës shënoi rritje reale prej 2.1 përqind në tremujorin e tretë të 2022, rritje që sipas Eurostat, kryesisht u mbështet nga rritja e kërkesës së brendshme pas një sezone të mirë turistike (veçanërisht në Itali dhe Spanjë), dhe nga rritja e kërkesës për shërbime pas largimit të pjesës më të madhe të masave kundër COVID-19.** Projektionet për rritje vjetore ekonomike për eurozonën u rishikuan në dhjetor kundrejt projeksioneve të shtatorit, në 3.4 përqind për vitin 2022, 0.5 përqind për vitin 2023 dhe 1.9 përqind për vitin 2024. Ekonomia e eurozonës është ndër ekonomitë më të ekspozuara ndaj pasojave të shkaktuara nga lufta në Ukrainë, si rrjedhojë e afërsisë gjeografike me luftën por veçanërisht, për shkak të varësisë së madhe nga gazi i importuar nga Federata Ruse. Për pasojë, inflacioni në rritje, çmimet e larta të energjisë dhe paqëndrueshmëria e përgjithshme në ekonomi e shkaktuar nga lufta në Ukrainë rezultojnë të jenë përkthyer në rënie të fuqisë blerëse të konsumatorëve dhe rritje të kostos së prodhimit. **Norma e inflacionit në eurozonë ka vazhduar trendin e rritjes së mëtejshme duke arritur në 9.3 përqind në TM3 2022,** ku çmimet e energjisë dhe ushqimeve mbesin kontribuuesit kryesorë të inflacionit të përgjithshëm, megjithëse është evidentuar rritje e çmimeve edhe tek kategoritë e tjera. Tremujori i fundit i vitit 2022 dhe viti 2023 pritet të jenë shumë sfidues për eurozonën, si pasojë e presioneve inflacioniste dhe politikës së shtrënguar monetare, faktorë që pritet të tkurrin kërkesën e përgjithshme, ndërkohë që edhe aktiviteti ekonomik në nivel global pritet të shënojë rënie. **Në tetor, për herë të tretë brenda vitit 2022, BQE rriti normën bazë të interesit me 75 pikë bazë, duke arritur në nivelin prej 2 përqind, me qëllim të frenimit të shkallës së inflacionit.** Projektionet e muajit dhjetor të BQE-së për vitin 2022 sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë pritet të jetë 8.4 përqind, nga 8.1 përqind sa ishte parashikuar në shtator. Përkritazi me ndërhyrjet e politikës monetare dhe kanalit të pritur transmetues, BQE parashikon se inflacioni pritet të normalizohet në 3.4 përqind gjatë vitit 2024.

**Ngjashëm me eurozonën, edhe Ballkani Perëndimor u përball me rritje të ngadalësuar ekonomike në vitin 2022 kundrejt vitit paraprak, ndërkohë që tremujori i tretë rezultoi të ketë qenë më i mirë në vendet ku shërbimet kanë pjesëmarrje të lartë në BPV.** Deri në qershor 2022, rritja reale e BPV-së në rajon ishte 4.95 përqind, ndërkohë që për tërë vitin FMN parashikon rritje prej 3.4 përqind, dhe 2.6 përqind në 2023. Ngadalësimi i prituri i BPV-së në eurozonë, që përbën partnerin kryesor tregtar për rajonin, si dhe ndjeshmëria e vendeve të rajonit ndaj krizës së çmimeve të ushqimit dhe energjisë, pritet të reflektohen në dinamikat e përgjithshme ekonomike në rajon. **Norma më e lartë e inflacionit në TM3 2022 u shënuar në Bosnje dhe Hercegovinë prej 16.9 përqind, e ndjekur nga Mali i Zi prej 15.3 përqind, ndërkohë që Shqipëria shënoi normën më të ulët të inflacionit prej 7.9 përqind.**

### Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Sipas Bankës Botërore, çmimet e energjisë vazhduan të shënojnë rritje, ku mesatarja e çmimit të naftës së papërpunuar Brent arriti në \$ 99.2 për fuçi gjatë TM3 2022, që përbën rënie prej 12.0 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, por rritje prej 35.9 përqind krahasuar me TM3 2021. Trendi i rritjes së çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare pritet të vazhdojë në muajt e ardhshëm si pasojë e vendimit të shteteve anëtare të OPEC të cilat janë pajtuar që të reduktojnë prodhimin e naftës, vendim i cili u arsyetua me pasigurinë që rrethon ekonominë globale dhe perspektivën e tregut të naftës. Ndërsa gazi natyror arriti një mesatare tremujore prej \$60.2/mmbtu, që shënon një rritje prej 90.1 përqind krahasuar me tremujorin paraprak (grafik 1). Për më tepër gazi natyror në muajin gusht arriti çmimin prej \$70.0/mmbtu, duke shënuar rritjen më të lartë të të gjitha kohërave. Çmimi i lartë i gazit natyror vjen si rezultat i zvogëlimit të mëtejshëm të sasisë së furnizimit nga Federata Ruse, si kundërpërgjigje ndaj sanksioneve të vendosura nga Bashkim Evropian. Në muajin korrik, 27 vende anëtare të BE-së u pajtuan që ta reduktojnë furnizimin me gaz Rus në 15 përqind më pak krahasuar me vitin paraprak, ndërkohë që rritën përpjekjet për

Grafik 1. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare




Burimi: Banka Botërore.

ndërtimin e burimeve alternative të energjisë dhe krijimin e infrastrukturës përkatëse. Për më shumë, për të shmangur pengesat nga reduktimi eventual i furnizimit nga Federata Ruse shtetet e BE-së kanë filluar të importojnë gaz natyror të lëngshëm (GNL) në cisterna nga prodhuesit si SHBA-të dhe Katari, për ta zëvendësuar me gazin natyror të importuar nga Rusia.


**Rritja e lartë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ka ndikuar direkt në rritjen e çmimit të energjisë në eurozonë, i cili shënoi rritje prej 39.6 përqind.**

Sipas Eurostat, rritje më e lartë e çmimeve gjatë TM3 2022 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, është shënuar në kategorinë e gazit prej 62.7 përqind, e përcjellur nga energjia elektrike me rritje prej 38.3 përqind, dhe nafta me rritje prej 31.8 përqind (grafik 2). Faktorët gjeopolitikë dhe vështirësitë infrastrukturore kanë kontribuar në rritjen e kostove të energjisë, veçanërisht pushtimi i Ukrainës nga Rusia në fillim të vitit 2022. Gjenerimi më i ulët i energjisë nga burimet e ripërtëritshme përmes diellit dhe erës në TM3 2022 rriti më tej varësinë nga gazi natyror. Rritja e lartë e çmimeve të gazit natyror ka rikthyer përdorimin e qymyrit për prodhim të energjisë elektrike në shume vende, faktor që po ndikon në rritjen e emetimit të CO2 në nivel global.

**Grafik 2. Çmimet e energjisë në eurozonë**



**Grafik 3. Çmimet e metaleve në tregjet ndërkombëtare**




**Çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rënie prej 18.2 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa rënie prej 11.0 përqind krahasuar me TM3 2021 (grafik 3).** Ngadalësimi i kërkesës nga importuesi kryesor i metaleve, Kina, prospektet për recesion potencial në nivel global, rivlerësimi i dollarit amerikan, dhe shtrëngimi i politikës monetare rezultojnë të kenë ndikuar në rënien e çmimeve të metaleve bazë.

**Indeksi i çmimeve të plehut artificial shënoi rënie prej 7.57 përqind, si rezultat i rënies së kërkesës nga çmimi i lartë në muajt paraprak të vitit 2022.** Me gjithë rënien e shënuar, çmimi i plehut artificial vazhdon të jetë i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Çmimet e plehut artificial u rritën në nivele rekorde në fillim të vitit, pas sanksioneve kundër Bjellorusisë e cila është një ndër prodhuesit kryesor, por dhe lufta e Rusisë në Ukrainë nxiti rritjen e çmimeve të plehut artificial prodhimi i të cilit ndërlidhet me gazin natyror. Situata e krijuar bëri që shumë vende importuese të plehut artificial të rrisin blerjet dhe të transportojnë sasi masive të produktit, për të shmangur problemet në zinxhirët e furnizimit dhe kufizimet tregtare në tregjet e eksportit si Rusia. Çmimi i lartë i plehut artificial krijon shumë pasiguri lidhur me krizën potenciale në sigurinë e ushqimit në nivel global.

**Indeksi i çmimeve të ushqimit sipas FAO shënoi rënie prej 12.1 përqind krahasuar me tremujorin paraprak.** Pavarësisht kësaj rënie, çmimet e ushqimit vazhdojnë të jenë më të larta krahasuar me vitin paraprak prej 8.5 përqind (grafik 4). Çmimet e ushqimit shënuan rënie në TM3 2022 kryesisht për shkak të çmimeve më të ulëta të grurit dhe vajit, korrjeve më të mira kundrejt vitit paraprak dhe ngadalësimit të përgjithshëm të ekonomisë globale. Faktor përcaktues në dinamikën e çmimeve të ushqimit po ashtu rezultoi të ketë qenë marrëveshja mes Ukrainës dhe Rusisë për lejimin e eksportit të drithërave dhe produkteve tjera ushqimore nga Ukraina përmes një korridori të sigurtë në Detin e Zi.

Grafik 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit




## Ekonomia e Kosovës

### Rritja Ekonomike

**Aktiviteti ekonomik në Kosovë, sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shënoi rritje reale prej 2.07 përqind në TM3 2022.** Ndryshe nga tremujori paraprak, kërkesa e brendshme kontribuoi pozitivisht në rritjen reale të BPV-së me 1.4 pikë përqindje (-4.3 pikë përqindje në TM2 2022), ndërkaq kontributi i neto eksporteve mbeti pozitiv me 0.7 pikë përqindje por që kundrejt tremujorit paraprak përbën ngadalësim të dukshëm (grafik 5).

Konsumi privat kontribuoi me 2.08 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së mbështetur nga dinamikat pozitive në burimet kryesore të financimit si rritja e kompensimit të punëtorëve, remitencave, kredive të reja për konsum, si dhe rritja e transfereve publike. Krahasuar me tremujorin paraprak, kontributi nga konsumi privat në TM3 2022 rezultoi të jetë ngadalësuar, që kryesisht mund t'i atribuohet përkthimit të krizës së çmimeve në rënien e fuqisë blerëse, si dhe çmimeve më të larta të mallrave të importuara. Krahas konsumit privat, edhe konsumi publik shënoi rritje duke dalur nga territori negativ, sidoqoftë, vlera e kontributit në gjithsej BPV-në ishte vetëm 0.05 pikë përqindje dhe i atribuohet rritjes së konsumit publik të mallrave dhe shërbimeve. Për dallim, investimet shënuan kontribut negativ prej 0.8 pikë përqindje në BPV-në reale, kryesisht si pasojë e rënies së shpenzimeve kapitale nga qeveria, rënies së kredive të reja investuese, si dhe ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në sektorin e ndërtimit. Sa i përket tregtisë së jashtme, kontributin kryesor brenda kësaj kategorie e dha eksporti i shërbimeve ndërsa edhe rënia në importin e mallrave ndikoi pozitivisht në normën reale të BPV-së duke neutralizuar sadopak kontributin negativ nga importi i shërbimeve.

Grafik 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Sipas qasjes së prodhimit, rritja reale e ekonomisë së Kosovës gjatë TM3 2022 është mbështetur kryesisht nga rritja në sektorin e (i) aktiviteteve financiare dhe të sigurimit (12.7 përqind rritje vjetore), (ii) aktiviteteve shkencore, profesionale dhe teknike, aktiviteteve të shërbimeve administrative dhe mbështetëse (8.6 përqind), (iii) informacionit dhe komunikimit (8.3%), (iv) industrisë përpunuese (9.2 përqind), e të tjera. Në anën tjetër, rënie e vlerës së shtuar gjatë TM3 2022 vazhdoi të shënohet në sektorin e ndërtimitarisë që shënoi rënie prej 7.8 përqind. Kjo rënie e aktivitetit ekonomik në sektorin e ndërtimit në masë të madhe i atribuohet rritjes së kostos së ndërtimit. Ndërsa, zvogëlimi i hendekut të prodhimit në këtë sektor në raport me tremujorin paraprak (-17.9 përqind në TM2 2022) u mbështet nga rritja e IHD-ve në ndërtimtari dhe në aktivitete të patundshmërisë.**

**Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik u pasqyrua edhe në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara në TM3 2022, që arriti në 2,722 ndërmarrje gjegjësisht 4.9 përqind më pak se në TM2 2022.** Numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara në krahasim me tremujorin paraprak u shënuar në sektorët e tregtisë, hotelarisë, aktiviteteve administrative dhe mbështetëse, informacionit dhe komunikimit, etj. Ndërsa, sektorët të cilët u preferuan nga ndërmarrësit në TM3 2022 përfshijnë prodhimin, rekreacionin dhe kulturën, aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, si dhe aktivitete të shërbimeve tjera. Në anën tjetër, gjatë TM3 2022, u mbyllën 372 ndërmarrje apo 19.1 përqind më pak krahasuar me tremujorin paraprak.

**Parashikimet e BQK-së për tërë vitin 2022 sugjerojnë për rritje reale ekonomike prej 2.9 përqind (grafik 5).** Dinamikat që karakterizuan aktivitetin e përgjithshëm ekonomik gjatë periudhës janar-shtator vlerësohet të kenë vazhduar edhe në pjesën e mbetur të vitit 2022, si rrjedhojë e vazhdimit të presioneve inflacioniste me bazë të gjerë dhe ndikimit rezultues në rënien e fuqisë blerëse dhe besueshmërinë e konsumatorëve. Sa i përket TM4 2022, të dhënat e fundit në dispozicion tregojnë për rënie të importit të mallrave konsumuese dhe rënie të kredive të reja konsumuese, që mund konsiderohen si indikacione për trendin e konsumit. Sidoqoftë, transferet publike në kuadër të pakos për përballje me inflacion, rritja e remitançave si dhe lehtësimi i çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare pritet të mbështesin konsumin. Për më shumë, investimet pritet të ndikohen nga shkalla më e lartë e shpenzimeve kapitale në tremujorin e fundit të vitit, si dhe nga rritja e importit të mallrave kapitale evidente në tetor 2022, por që efekti pritet të neutralizohet nga rënia e pritur e investimeve në sektorin e ndërtimit në tremujorin e fundit. Eksportet neto pritet të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike si rezultat i rënies së importit të mallrave dhe shërbimeve krahas rritjes së eksportit në të dy kategoritë.

## Çmimet


**Norma vjetore e inflacionit në Kosovë në TM3 2022 arriti në 13.3 përqind, që paraqet një rritje prej 0.7 pikë përqindje krahasuar me tremujorin paraprak.** Sidoqoftë, trendi i inflacionit përgjatë kësaj periudhe tregon për ngadalësim të rritjes së çmimeve në baza mujore, ku gjatë muajit shtator norma e inflacionit ra në 12.7 përqind nga piku prej 14.2 përqind që arriti në korrik. Ky ngadalësim i rritjes së çmimeve reflekton zbutjen e presioneve në çmimet e energjisë dhe ushqimit, pas rënies së çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare dhe lehtësimit të pengesave në zingjirët e furnizimit të mallrave ushqimore.

**Presionet inflacioniste globale vazhdojnë të diktojnë edhe çmimet në Kosovë, me rrezik amplifikimi kur kemi parasysh ndjeshmërinë që ka ekonomia e vendit si pasojë e koncentrimin të lartë të komponentës së ushqimit dhe energjisë në shportën konsumatore (rreth 55.5 përqind) dhe shkallës së lartë të importit.** Rrjedhimisht, kategoritë me rritjen më të lartë të çmimeve krahasuar me TM3 2021 përfshijnë atë të ushqimit dhe pijeve joalkoolike dhe transportit, që shënuan rritje prej 19.5 përqind dhe 18.2 përqind respektivisht. Krahasuar me tremujorin paraprak, norma vjetore e inflacionit të ushqimit në TM3 2022 shënoi rritje prej 2.9 pikë përqindje, ndërsa rritja e çmimeve të transportit shfaqti ngadalësim duke rënë për 5.7 pikë përqindje. Në kuadër të kategorisë së ushqimit dhe pijeve joalkoolike, rritja më e lartë vjetore u shënuar në çmimet e vajrave dhe yndyrave (52.0 përqind), bukës dhe drithërave (32.7 përqind), qumështit, djathit dhe

vezëve (26.1 përqind) dhe mishit (22.2 përqind). Në baza mujore, vërehet përsheptim në rritjen e çmimit të bukës dhe drithërave, dhe rritje e ngadalësuar e çmimeve të vajrave dhe yndyrave, pemëve, dhe perimeve.

**Kontributi i ushqimit në inflacionin e përgjithshëm në TM3 2022 ishte 7.4 pikë përqindje**, ku 2.4 pikë përqindje paraqesin kontributin nga rritja e çmimeve të bukës dhe drithërave, 2.1 pikë përqindje ishte kontributi nga rritja e çmimit të mishit, kurse 1.6 pikë përqindje përbëjnë kontributin nga çmimet e qumështit, djathit, dhe vezëve. Ndërsa, në kuadër të kategorisë së transportit që shënoi kontribut prej 2.9 pikë përqindje në gjithsej normën e inflacionit, pjesa më e madhe vjen nga kategoria përdorimi i pajisjeve për transportin personal (ku përfshihen karburantet) me kontribut prej 2.1 pikë përqindje.

Grafik 6. Kontributi i nëngrupeve përkatëse në IÇK




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK) tregon për zgjerim të bazës së inflacionit në TM3 2022, ku pjesa më e madhe e shportës së konsumit (80.0 përqind e shportës) shënoi rritje të çmimeve më të lartë se 5.0 përqind.** Zgjerimi i bazës së inflacionit si rrjedhojë e rritjes së kërkesës kundrejt rritjes më të ngadalshme të ofertës dhe bartja e kostos së rritur të çmimeve të energjisë në çmimet e mallrave dhe shërbimeve tjera ndikoi që kontributi i mallrave dhe shërbimeve (përfshijë ushqimin dhe energjinë) në inflacionin e përgjithshëm të ngritet dukshëm (grafik 6). Kontributi nga sektori i shërbimeve, që ofron një pasqyrë të inflacionit të nxitur nga ekonomia e brendshme, arriti në 1.5 pikë përqindje në TM3 2022 nga 0.2 pikë përqindje në TM3 2021. Në kuadër të kategorisë së shërbimeve, inflacioni buron nga shtrenjtimi i shërbimeve hoteliere, shërbimeve të transportit, kujdesit personal, dhe mirëmbajtjes dhe rregullimit të vendbanimit. Gjatë muajve korrik dhe gusht 2022, kontribut të qenësishëm në rritjen e çmimeve të shërbimeve rezultojnë të ketë dhënë nënkategoria pushime të organizuara në kuadër të rekreacionit dhe kulturës, kontribut i cili u zbeh në shtator.

**Shpërndarja e inflacionit në sektorë tjerë vërehet po ashtu në rritjen e inflacionit bazë**, i cili tregon prirjen më afatgjatë të inflacionit, duke përjashtuar në mënyrë konsistente kategoritë e IÇK-së me luhatjet më të shpeshta të çmimeve (ushqimin dhe pijet joalkoolike, pijet alkoolike dhe duhanin, dhe energjinë). Inflacioni bazë në TM3 2022 arriti në 6.5 përqind, që krahasuar me tremujorin paraprak shënon rritje prej 1.2 pikë përqindje, kryesisht si rezultat i rritjes së kostos së shërbimeve (grafik 7). Sidoqoftë, në baza mujore, vërehet rënie edhe në inflacionin bazë si rrjedhojë e zbutjes së presioneve inflacioniste nga ngadalësimi i çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare dhe ndikimi rezultues në sektorë tjerë, si dhe tkurrjes së kërkesës sidomos në sektorin e shërbimeve në fund të TM3 2022.

**Pjesa më e madhe e inflacionit në Kosovë është e importuar si rrjedhojë e varësisë së ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave energetike dhe ushqimore, peshës së konsiderueshme të këtyre mallrave në shportën e konsumatorit, si dhe rritjes së konsiderueshme të çmimeve të tyre (grafik 8).** Sidoqoftë, së fundmi ka filluar të theksohet rritja e inflacionit të brendshëm si rezultat i rritjes së kostove të inputeve të ndërmjetme në prodhimin vendor dhe bartjes së kostos së ngritur nga ndërmarrjet tek konsumatorët.


Grafik 7. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Ndikimi i ekonomisë së Kosovës nga lëvizja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare po ashtu u pasqyrua në rritjen e indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) i cili arriti në 17.5 përqind në TM3 2022 krahasuar me TM3 2021 (14.7 përqind).** Çmimet e (i) produkteve minerale, (ii) artikujve të gurit, llaçit, dhe produkteve të qeramikës dhe qelqit, si dhe (iii) plastikës, kauçikut, dhe artikujve të tyre, që paraqesin kategoritë kryesore të IÇIMP në TM3 2022, shënuan rritje prej 52.8 përqind, 41.2 përqind, respektivisht 18.9 përqind. Krahasuar me tremujorin paraprak kur IÇIMP arriti nivelin më të lartë prej 23.3 përqind, ky indeks tregon për ngadalësim të rritjes së çmimeve të mallrave të importuara në TM3 2022, posaçërisht të çmimeve të mallrave industriale (metalet bazë dhe artikujt e tyre, produktet minerale, produktet e industrive kimike).

Grafik 8. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Në të njëjtën periudhë, indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) shënoi rritje vjetore prej 17.2 përqind, ndërsa u rrit për 7.2 pikë përqindje krahasuar me TM2 2022.** Kategoritë me peshën më të madhe në këtë indeks si (i) energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar, (ii) prodhimi i produkteve minerale jometalike, dhe (iii) përpunimi i produkteve ushqimore shënuan rritje prej 49.7 përqind, 7.3 përqind, dhe 14.2 përqind respektivisht. Ndërsa, rënie u shënuar në çmimet e nxjerrjes së xehes së metalit prej 28.8 përqind, dhe prodhimit të mobiljeve prej 7.3 përqind.

**Me rritje vjetore prej 19.5 përqind u karakterizua indeksi i kostos së ndërtimit (IKN) në TM3 2022.** Në raport me tremujorin paraprak, dinamikat e IKN-së japin sinjale pozitive sa i përket ritmit të rritjes së kostos së ndërtimit duke treguar për ngadalësim të rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore, që përbëjnë më shumë se gjysmën e peshës së IKN-së (23.4 përqind në TM2 2022, ndërsa 21.6 përqind në TM3 2022). Ndërsa brenda këtij indeksi, rritje e dukshme u vërejt në koston e energjisë (49.7 përqind) dhe transportit (40.4 përqind).



### Projeksionet e BQK-së parashohin që inflacioni në Kosovë për vitin 2022 të arrijë në 11.5 përqind.

Trendi zbritës i inflacionit në eurozonë dhe në ekonominë botërore në përgjithësi si rezultat i shtrëngimit të kushteve të financimit pritet të reflektohet edhe në ekonominë e vendit. IÇK pritet të ndjekë trend zbritës përgjatë pjesës së mbetur të vitit 2022 duke arritur në 11.9 përqind në TM4 2022, dhe të bie në 5.7 përqind në vitin 2023. Sidoqoftë, rreziqet nga kahu i lartë të ndërlidhura me inflacionin, ndonëse me gjasa më të ulëta të materializimit, mbesin akoma prezente duke përfshirë shfaqjen e pengesave të reja në zingjirët e furnizimit dhe rritjen e çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare, pritet e konsumatorëve për ngritje të mëtejshme të inflacionit, e të tjera.

Në anën tjetër, pritet e bankave për inflacionin kanë vazhduar të ndjekin trend rritës, megjithëse mbesin nën vlerat faktike të IÇK-së, dhe nuk ndjekin trendin zbritës të inflacionit nga muaji gusht tutje.


### Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore në TM3 2022 arritën vlerën neto 712.7 milionë euro apo 13.4 përqind më shumë se tremujori i njëjtë i vitit paraprak. Rritja e arkëtimit të të hyrave buxhetore erdhi si rezultat i rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik, normës së lartë të inflacionit, si dhe përpjekjeve të ndërmarra për ngushtimin e hendekut tatimor në vend. Ngjashëm, rritje u shënuar edhe në shpenzimet buxhetore të cilat arritën vlerën 595.3 milionë euro apo rritje prej 20.0 përqind krahasuar me TM3 2021. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 117.4 milionë euro gjatë këtij tremujori.

#### Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore në TM3 2022, 88.5 përqind përbëjnë të hyra nga tatimet

ku u vërejt rritje më e lartë e të hyrave tatimore indirekte të cilat arritën vlerën neto 532.6 milionë euro pas kthimeve tatimore, dhe në këtë cilësi përbënë 74.7 përqind të gjithë të hyrave buxhetore. Në kuadër të tatimeve indirekte, të hyrat nga TVSH-ja shënuan rritje prej 17.0 përqind duke u ndikuar dukshëm nga rritja e çmimeve dhe rritja e aktivitetit ekonomik. Ndërsa, përkundër rënies së sasisë së importit, të hyrat nga detyrimi doganor dhe akciza shënuan rritje modeste prej 1.4 përqind respektivisht 6.1 përqind si rezultat i rritjes së çmimeve të mallrave të importuara. Tutje, të hyrat nga tatimet direkte arritën vlerën 98.3 milionë euro apo 16.9 përqind më shumë krahasuar me TM3 2021. Në kuadër të kësaj kategorie, tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje vjetore prej 30.8 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat personale si kategoria kryesore e të hyrave tatimore direkte, shënoi rritje vjetore prej 15.2 përqind. Në anën tjetër, të hyrat jo-tatimore që kryesisht përfshijnë të hyra nga organizatat buxhetore arritën vlerën 71.5 milionë euro duke shënuar rënie prej 1.14 përqind, kryesisht si rezultat i rënies së të hyrave nga qeveria lokale në shtator 2022 (grafik 9).

Grafik 09. Struktura e të hyrave tatimore



Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.

#### Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse në TM3 2022 ishin 516.5 milionë euro apo 28.1 përqind më të larta krahasuar me TM3 2021.

Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, subvencionet dhe transferet shënuan rritje prej 65.0 përqind dhe arritën vlerën 291.5 milionë euro. Shpenzimet e qeverisë për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) shënuan rritje vjetore prej 11.0 përqind dhe arritën vlerën 76.2 milionë euro, ndërsa shpenzimet për paga shënuan rënie prej 5.8 përqind duke arritur vlerën 148.8 milionë euro. Ndryshe nga shpenzimet rrjedhëse, shpenzimet kapitale shënuan rënie prej 15.1 përqind krahasuar me TM3 2021, duke arritur në 78.8 milionë euro (grafik 10). Gjatë këtij tremujori, shpenzimet

kapitale përbënin vetëm 13.2 përqind të gjithsej shpenzimeve buxhetore në krahasim me 18.7 përqind në TM3 2021.


**Borxhi publik në TM3 2022 arriti në 1.69 miliardë euro, që paraqet rritje prej 2.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.** Kjo rritje i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm publik prej 2.7 përqind duke arritur në 1.11 miliardë euro, si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik prej 1.4 përqind që arriti në 577.4 milionë euro. Borxhi i brendshëm kryesisht përbëhet nga borxhi i Qeverisë së Kosovës ndaj fondeve pensionale (50 përqind), bankave komerciale (25 përqind), institucioneve publike (19 përqind), kompanive të sigurimeve (4 përqind), etj. Ndërsa, borxhi i jashtëm përbëhet nga detyrimet ndaj Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (29.4 përqind), Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (17.6 përqind), Fondit Monetar Ndërkombëtar (9.4 përqind), etj. Përkundër rritjes së borxhit publik në terma absolutë, niveli i borxhit publik si përqindje e BPV-së ra në 20.5 përqind në TM3 2022 (23.0 përqind në TM3 2021) duke vazhduar kështu të jetë nën pragun prej 40 përqind të paraparë me ligj. Kjo ulje në TM3 2022 i atribuohet bilancit pozitiv buxhetor të qeverisë dhe rritjes së BPV-së nominale e cila reduktonte raportin e borxhit ndaj BPV-së.

### Sektori i jashtëm


Dinamika e zhvillimeve në llogarinë rrjedhëse të Kosovës vazhdon të përcaktohet kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të vendit. Në nëntë muajt e parë të vitit 2022, pozicioni i llogarisë rrjedhëse u përkeqësua si pasojë e rritjes së deficitit në tregtinë e mallrave, përderisa bilanci pozitiv në tregtinë e shërbimeve dhe të kategorive siç janë të ardhurat primare dhe sekondare kontribuuan në ngushtimin e këtij deficiti. **Për dallim nga dinamikat nëntë mujore, llogaria rrjedhëse në TM3 2022 shënoi bilanc pozitiv prej 157.5 milionë euro, që konsiston me një rritje vjetore prej 9.3 përqind. Rritja e bilancit pozitiv të llogarisë rrjedhëse kryesisht i atribuohet rritjes së bilancit pozitiv të shërbimeve dhe të ardhurave dytësore (ndikimit të diasporës). Në anën tjetër, bilanci i mallrave, i ndikuar nga rritja e çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare, kishte ndikim negativ në llogarinë rrjedhëse (grafik 11).**

Deficiti tregtar i mallrave në TM3 2022 shënoi vlerën prej 1.2 miliard euro, që korrespondon me një rritje vjetore prej 22.7 përqind (grafik 12). Arsyeja kryesore e rritjes së deficit tregtar ndërlidhet me rritjen e theksuar të importit të mallrave. Gjithsej importi i mallrave gjatë TM3 2022 ishte 1.5 miliardë euro, ndërsa eksporti arriti vlerën prej 238.2 milionë euro, që nënkupton se eksporti i mallrave arrin të mbulojë vetëm 15.8 përqind të mallrave të importuara. Deficiti tregtar i mallrave përbën një problem strukturor në ekonominë e vendit dhe rritja e vazhdueshme e importit të mallrave, sidomos atyre konsumuese dhe të ndërmjetme, sinjalizon për rritjen e ndjeshmërisë së ekonomisë së vendit ndaj dinamikave në tregjet ndërkombëtare.

Grafik 10. Struktura e shpenzimeve buxhetore




Grafik 11. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro




Eksporti i mallrave në TM3 2022 shënoi rritje vjetore prej 21.2 përqind, rritje që kryesisht i atribuohet rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që pesha e mallrave të eksportuara shënoi rënie prej 35.1 përqind. Dinamikat inflacioniste janë reflektuar në tregtinë e jashtme të Kosovës kryesisht përmes rritjes së eksportit të produkteve minerale, produkteve të plastikës dhe gomës, dhe artikujve ushqimor (grafik 13). Partnerët kryesor tregtarë të Kosovës gjatë TM3 2022 ishin shtetet e BE-së dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat kishin një pjesëmarrje të barabartë prej 36.3 përqind në gjithsej eksportin e mallrave. Në kuadër të vendeve të BE-së, eksportet kosovare ishin kryesisht të përqendruara në Gjermani, Itali, Danimarkë dhe Holandë, ndërsa në vendet e rajonit më së shumti është eksportuar në Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi.

Grafik 12. Bilanci tregtar i mallrave




Burimi: ASK.

Grafik 13. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.


Grafik 14. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.

Rritja e lartë e çmimeve ka ndikuar në rritjen e importit të mallrave prej 18.8 përqind në TM3 2022, duke arritur vlerën prej 1.5 miliardë euro, ndërsa ngadalësimi i rritjes së kërkesës së përgjithshme në vend ka ndikuar që pesha e importit të mallrave të shënojë rënie prej 14.3 përqind. Edhe të dhënat e BPV-së për TM3 2022 sugjerojnë për një rënie reale të importit të mallrave prej 1.4 përqind. Përderisa struktura e partnerëve tregtar dhe kategorive kryesore të importit mbeti e pandryshuar, Kosova kryesisht importoi produkte minerale dhe metale nga vendet e rajonit, artikuj ushqimor dhe metale nga vendet e BE-së, ndërsa nga Kina u importuan kryesisht makineri, pajisje elektrike, dhe artikuj prej plastike.

Grafik 15. Bilanci i shërbimeve



Burimi: BQK.


**Për dallim nga bilanci tregtar i mallrave, shërbimet shënuan bilanc pozitiv në TM3 2022.** Eksporti i shërbimeve arriti vlerën prej 1.2 miliardë euro në TM3 2022, një rritje vjetore prej 12.8 përqind (Grafik 15).

Eksporti i shërbimeve shënoi rritje të theksuar si rezultat i rritjes së eksportit të shërbimeve të udhëtimit, të cilat arritën vlerën prej 991.9 milionë euro apo 14.8 përqind më shumë krahasuar me TM3 2021. Rritje e lartë vjetore prej 35.1 milionë euro është shënuar edhe tek eksporti i shërbimeve kompjuterike dhe të telekomunikacionit, kategori që arriti në 61.6 milionë euro në TM3 2022. Importi i shërbimeve shënoi rritje prej 39.4 përqind në TM3 2022, duke arritur vlerën prej 435.7 milionë euro. Rritje më e lartë është shënuar tek importi i shërbimeve të udhëtimit dhe transportit, që ndërldhet edhe me rritjen e kostove si pasojë e rritjes së çmimeve të mallrave kryesore.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore shënoi rënie prej 23.4 përqind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, rënie që kryesisht iu atribuua kthimit të dividendës nga investimet direkte në vlerë prej 73.5 milionë euro apo 27.8 milionë euro më shumë se në TM3 2021. Rritje prej 20.1 përqind është shënuar edhe tek kompensimi i punëtorëve, bilanci i të cilit arriti në 76.7 milionë euro (grafik 16). Remitancat përbëjnë një ndër financuesit kryesor të konsumit, dhe kanë një pjesëmarrje prej 14.1 përqind në gjithsej BPV-në e gjeneruar në vend. Vlera e remitancave të pranuar në TM3 2022 arriti në 349.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 13.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 17). Remitancat kryesisht vijnë nga Gjermania (39.4 përqind), Zvicra (18.2 përqind) dhe SHBA-të (8.2 përqind e gjithsej remitancave të pranuar në Kosovë). Përveç faktorit altruist që karakterizon dërgesat e emigrantëve në Kosovë, e që mund të jetë përforcuar si pasojë e tkurrjes së të ardhurave të disponueshme në ekonomi si pasojë e inflacionit, rritja e remitancave gjatë muajve të verës mund t'i atribuohet edhe zhvlerësimit të euros ndaj valutave tjera. Në TM3 2022, është vënë re një rritje prej 21.6 përqind e remitancave të dërguara përmes bankave, ndërsa remitancat përmes agjencioneve për transferimin e mjeteve shënuan rritje prej 14.3 përqind.


IHD-të në TM3 2022 arritën vlerën prej 239.5 milionë euro, apo 41.2 përqind më shumë krahasuar me TM3 2021. Rritja më e madhe është vërejtur tek kapitali dhe fondi i investimeve në aksione prej 212.9 milionë euro, apo 26.5 përqind rritje krahasuar me TM3 2021 (grafik 18). Ndërsa instrumentet e borxhit shënuan rritje prej

Grafik 16. Bilanci i të ardhurave parësore




Burimi: BQK.

Grafik 17. Remitencat



Burimi: BQK.

Grafik 18. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

26.7 milionë euro. Struktura e IHD-ve vazhdon të jetë e koncentruar kryesisht në sektorin e patundshmërive (67.9 përqind e gjithsej IHD-ve në TM3 2022), të cilat shënuan rritje prej 32.9 përqind. Kjo rritje e IHD-ve në patundshmëri ndër të tjera mund t'i atribuohet edhe rritjes prej 19.5 përqind gjatë TM3 2022 të çmimeve të inpleteve për koston e ndërtimit. Edhe sektorët tjerë shënuan performancë të mirë, ku bilanci i fitimit të ri-investuar vetëm gjatë këtij tremujori ishte 40.0 milionë euro, apo 21.1 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2021. Edhe investimet direkte të rezidentëve kosovarë në vende tjera ishin më të larta në TM3 2022 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe arritën vlerën prej 39.4 milionë euro (37.0 milionë euro në TM3 2021). Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e patundshmërive, kryesisht në vendet e rajonit (Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni e Veriut).

## Sistemi financiar

**Sistemi financiar u karakterizua me zgjerim të theksuar të aktivitetit, përkundër rritjes së lartë të inflacionit, shqetësimeve rreth ngadalësimit ekonomik si dhe luhatshmërive të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare.**


Presionet e vazhdueshme inflacioniste kanë frenuar rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike pas-pandemike, duke rritur pasiguritë dhe ndjeshmërinë edhe të sistemit financiar. Asetet e sistemit financiar në vend ngadalësuan rritjen vjetore për 2.1 pikë përqindje, dhe vlera e tyre arriti në 9.4 miliardë euro. Ngadalësimi i trendit të rritjes u ndikua nga zhvillimet në sektorin bankar dhe sektorin pensional, përdërisa asetet e sektorëve tjerë shënuan përshpejtim të rritjes (grafik 19). Rritja më e ngadalësuar në sektorin bankar erdhi kryesisht si rezultat i ngadalësimit të rritjes së depozitave. Ndërsa, sektori pensional u karakterizua me rënie të vlerës së investimeve, që u reflektua në pothuajse përgjysmim të trendit të rritjes së aseteve të këtij sektori.

Sektori bankar në shtator 2022 përfaqësoi 68.2 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, duke dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e gjithsej aseteve të sistemit financiar, megjithëse në nivel më të ngadalësuar se periudha e kaluar (grafik 20). Ndërsa sektori mikrofinanciar, i sigurimeve dhe ndërmjetësve financiar, për shkak të peshës më të ulët, kishin ndikim më të kufizuar në strukturën e përgjithshme të aseteve të sistemit përkundër përshpejtimin të rritjes gjatë kësaj periudhe.

### 1. Sektori bankar


**Rreziqet për sektorin bankar nga zhvillimet jo të favorshme gjeopolitike, markoekonomike e financiare mbesin të rritura, megjithëse në nëntë muajt e parë të vitit 2022 nuk rezultojnë të jenë përkthyer në aktivitetin dhe performancën e sektorit.** Presionet e vazhdueshme inflacioniste vlerësohet të

**Grafik 19. Vlera e aseteve e sistemit financiar të Kosovës**



Burimi: BQK.

**Grafik 20. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje**



Burimi: BQK.

kenë ndikuar në rënien e të ardhurave të disponueshme në ekonomi, duke u përkthyer në rënie potenciale të kapacitetit ripagues të huamarrësve (rritje të rrezikut kreditor) dhe dobësim të kapacitetit kursyes (rritje e rrezikut të likuiditetit). Rritja e shpenzimeve të energjisë gjatë periudhës së dimrit si dhe ndërprerjet potenciale të energjisë pritet të kontribuojnë tutje në rritjen e rrezikut kreditor për sektorin bankar.

### Asetet


Ngadalësimi i rritjes së depozitave, i cili është burimi kryesor i financimit të sektorit bankar, ndikoi në ngadalësim të rritjes së gjithsej asetëve të sektorit bankar (grafik 21). Sidoqoftë, aktiviteti kreditues u karakterizua me përshejtim të theksuar të rritjes, duke dhënë kontributin kryesor pozitiv në rritje të asetëve. Bilanci me bankat tjera komerciale shënoi rënie vjetore prej 23.9 përqind, për dallim nga rritja prej pikërisht 23.9 përqind në vitin paraprak. Në kuadër të investimeve në letra me vlerë, me rritje vjetore prej 15.5 përqind u karakterizuan investimet në tregun e jashtëm, ndërsa bilanci i investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës shënoi rënie prej 14.6 përqind. Kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në shënoi rritje vjetore prej 24 përqind, të ndikuar kryesisht nga rritja e rezervave të bankave me BQK-në.

### Kreditimi

**Aktiviteti kreditues i sektorit shënoi rritje vjetore prej 18.4 përqind, që përkon me shkallën më të lartë të rritjes në 12 vitet e fundit. Rritja e lartë e kreditimit të sektorit vazhdoi edhe në tremujorin e tretë të vitit, ndikuar kryesisht nga kërkesa për kredi, përderisa oferta u karakterizua me shtrëngim të lehtë kryesisht si pasojë e pasigurisë rreth perspektivës së tregut vendor. Rritja e kërkesës për financim të inventarëve dhe kapitalit punues nga ndërmarrjet e mëdha, si dhe rritja e kërkesës për kredi konsumuese ndikuan rritjen e përgjithshme të kërkesës, në nivel marginal në raport me tremujorin paraprak, përderisa kërkesa për kredi nga NVM-të si dhe kërkesa për kredi për blerje të patundshmërive rezultojnë të kenë shënuar rënie.**


Me rritje më të theksuar të kreditimit prej 18.4 përqind u karakterizua segmenti i korporatave jofinanciare, vlera e kredive të së cilit arriti në 2.6 miliardë euro

**Grafik 21. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet**




Burimi: BQK.

**Grafik 22. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor**



Burimi: BQK.

**Grafik 23. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje**




Burimi: BQK.

(grafik 22). Rritja e kreditimit të korporatave jo-financiare ishte pothuajse dyfish më e lartë në raport me rritjen prej 10.2 përqind në vitin paraprak, duke thuhajse dyfishuar edhe kontributin dominues që e ka ky segment në gjithsej rritjen e kreditimit të sektorit (grafik 23). Kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 17.3 përqind, që është më e përafërt me rritjen prej 15.8 përqind në vitin paraprak.


Kreditë e reja u rritën ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit 2021, me 16.3 përqind. Por, për dallim nga viti i kaluar që u karakterizua me rritje më të lartë të kredive të reja nga ekonomitë familjare, këtë vit rritja ishte shumë më e theksuar për korporatat jofinanciare (grafik 24). Deri në shtator 2022, kreditë e reja të korporatave jofinanciare u rritën për 26.2 përqind. Rritja ishte e lartë si për kreditë investuese, 22.4 përqind, ashtu edhe për kreditë jo-investuese 27.6 përqind. Kreditë e reja për ekonomitë familjare shënuan rritje shumë më të ngadalësuar prej 4.7 përqind. Rritja ishte më e lartë tek kreditë konsumuese, 15.7 përqind, përderisa kreditë hipotekare ngadalësuan ritmin e lartë të rritjes që kishin vitin e kaluar, duke u rritur me 8.7 përqind deri në shtator 2022. Kjo periudhë u karakterizua me rritje të theksuar të përdorimit të produkteve kreditore si mbitërheqjet dhe linjat kreditore, si nga korporatat jofinanciare, ashtu edhe nga ekonomitë familjare.

Grafik 24. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 25. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 26. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

Në kuadër të kredive për korporatat jo financiare, sektori i tregtisë është më i kredituari ndër vite, pasuar nga ai prodhimtarisë dhe i ndërtimtarisë, të cilët janë zgjeruar gradualisht në vitet e fundit duke rritur pjesëmarrjen në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Deri në shtator 2022, kreditimi ndaj sektorit të prodhimtarisë kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive për segmentin e korporatave jofinanciare (grafik 25), si rezultat i rritjes së lartë vjetore - rritjen e dytë më të përshpejtuar vjetore (grafik 26). Sektori i shërbimeve financiare shënoi rritjen më të shpejtë kreditore - pothuajse dyfishoi portfolion në 223.3 milionë euro nga 124.7 milionë në vitin paraprak, dhe rezultoi sektori i tretë për nga kontributi në rritjen e gjithsej kredive të korporatave jofinanciare. Sektori i ndërtimtarisë shënoi rritje të përshpejtuar prej 29.9 përqind, përkundër sfidave me të cilat u përball ky sektor për shkak të rritjes së lartë të inflacionit – rritjes së çmimit të materialeve ndërtimore. Sektori i bujqësisë këtë vit u karakterizua me rritje pozitive, për dallim nga rënia e theksuar në vitin paraprak.

Kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, përkatësisht ndaj sektorit të prodhimit është mbështetur edhe nga Pako e Ringjalljes Ekonomike, përmes masës së subvencionimit të kredive investive për bizneset prodhuese. Zbatimi i kësaj mase gjatë këtij vitit mund të ketë ndikuar në përshpejtimin e rritjes së kredive për sektorin e prodhimit.


### 1.1. Detyrimet dhe burimet vetanake

**Financimi i aktiviteteve të sektorit bankar vazhdoi të mbështetet në depozitat e klientëve dhe kapitalit vetanak, konkretisht fitimit të mbajtur dhe fitimit të realizuar gjatë vitit aktual.** Të dy këto zëra përbëjnë rreth 92.4 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit, ku 81.5 përqind janë vetëm depozitat. Sidoqoftë, pasiguritë e rritura si pasojë e presioneve inflacioniste dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik u reflektuan në sjelljen konsumatore përmes ngadalësimit të rritjes së depozitave, gjë që shtyu sektorin bankar të ofroj kushte më të favorshme për sigurimin e financimit dhe të filloj me rritjen e normës së interesit në depozita.

#### 1.1.1 Depozitat


Vlera e stokut të depozitave në fund të shtatorit 2022 arriti në 5.26 miliardë euro (grafik 27), që paraqet një rritje vjetore të ngadalësuar prej 12.7 përqind, nga 15.1 përqind në shtator 2021.

Grafik 27. Stoku i gjithsej depozitave




Burimi: BQK.

Grafik 28. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 29. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Ngadalësimi i rritjes së gjithsej depozitave kryesisht reflekton ecurinë e depozitave të ekonomive familjare pasi që kanë peshën më të lartë në gjithsej depozitat (grafik 28), dinamikë e cila mund të jetë ndikuar nga shpenzimet më të larta gjatë këtij viti si rezultat i rritjes së çmimeve. Gjithsej depozitat prej ekonomive familjare në fund të shtatorit 2022 arritën vlerën prej 3.56 miliardë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 11.3 përqind (18.3 përqind një vit më parë). Sa i përket nivelit të depozitave të reja të arkëtuara nga ekonomitë familjare, ku përfshihen vetëm depozitat e afatizuara, ato gjatë periudhës janar-shtator 2022 arritën në vlerën prej 256.1 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 10.4 përqind, përderisa vitin paraprak kishte rënie vjetore prej 21.7 përqind (grafik 29). Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së normave të interesit në depozita për këtë kategori, të cilat u rritën nga bankat në përpjekje për të rritur depozitat/financimin për mbështetjen e shkallës



së lartë të kreditimit në vend, meqë rritja e normave të interesit në nivel global veçse ka ndikuar në rritjen e kostos së financimit nga jashtë.


Stoku i depozitave të korporatave jofinanciare në fund të shtatorit 2022 arriti në 1.06 miliardë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 16.2 përqind (28.4 përqind në shtator 2022). Depozitat e reja të arkëtuara në nëntë muajtë e parë të vitit nga ky segment shënuan rënie vjetore prej 25.7 përqind, ngjashëm me rënie prej 28.3 përqind në vitin paraprak. Ky zhvillim vlerësohet se është ndikuar nga aktiviteti i shtuar ekonomik i ndërmarrjeve në periudhën pas-pandemike, si dhe rritja e çmimeve, që kanë rritur nevojën për investim të mjeteve në kapital punues, me qëllim të zgjerimit dhe rezervimit të çmimeve aktuale, marrë parasysh pritjet për rritje të vazhdueshme të çmimeve.

## 1.2 Normat e interesit

Normat e interesit në kredi të reja dhe depozita kanë pësuar lëvizje në rritje, pas trendeve rënese në vitet paraprake. Në shtator 2022, norma e interesit në kredi ishte 6.3 përqind nga 5.9 përqind një vit më parë, kurse në depozita u ngrit në 1.9 përqind nga 1.4 përqind. Margjina e interesit kredi-depozitë u ngushtua në 4.3 pikë përqindje nga 4.5 pikë përqindje (grafik 30).


Dinamika e normave të interesit në kredi dhe depozita është ndikuar nga zhvillimet në nivel global, ku pjesa më e madhe e bankave qendrore në kundërpërgjigje të inflacionit kanë ngritur normat bazë të interesit. Gjithashtu, rritja e rrezikut të likuiditetit si pasojë e inflacionit të rritur ka shtyer bankat në rritjen e normave të interesit në depozita, me qëllim të tërheqjes së tyre. Këto zhvillime në të njëjtën kohë kanë ndikuar në ndryshimin e strukturës së kredive sipas llojit të normave të interesit. Përderisa në vitin e kaluar dhe deri në mars të këtij viti, kreditë me norma variable të interesit, që kryesisht përcaktohen nga lëvizjet e normës Euribor për marzhën shtesë, përbënin mesatarisht 16.7 përqind të portfolios kreditore, kjo përbërje këtë vit është ngritur në 21.8 përqind. Poashtu, disa banka që kanë aplikuar vetëm norma fikse, këtë vit filluan aplikimin e normave variable (grafik 30a).

Grafik 30. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.

Grafik 30a. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit



Burim: BQK.

Kjo dinamikë tregon për qasjen prudente që kanë adaptuar bankat për menaxhimin e rrezikut në rritje nga inflacioni, dhe zhvillimeve në të njëjtën kahje në nivel global. Pritjet janë që kjo pjesëmarrje si dhe rritja e

normave të interesit të vazhdojë edhe në periudhat në vazhdim, mbështetur edhe nga deklaratimet e bankave në Anketën e Kreditimit bankar.

**Norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare** në shtator 2022 qëndroi në 6.5 përqind, për 0.8 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Norma më të favorshme të interesit në kredi u ofruan për segmentin e shërbimeve (6.2 përqind), ndërsa norma më e lartë e interesit ishte për sektorin e bujqësisë prej 11.2 përqind për shkak të rrezikut më të lartë që bartin (grafik 31).


**Norma mesatare e interesit në kredi ndaj ekonomive familjare** në shtator 2022 qëndroi në 6.1 përqind, pothuajse e njëjtë me atë të një vit më parë. Normat e interesit për kreditë hipotekare janë më të favorshme (5.0 përqind) për shkak të rrezikut të ulët, pasi që janë të mbuluara me kolateral (hipotekë). Kurse, kreditë konsumuese vazhdojnë të kenë norma më të larta të interesit (6.4 përqind) edhe pse shënuan rënie marxhinale prej 0.4 pikë përqindje, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 32). **Normat e interesit në depozita** ndërprejnë trendin rënës të viteve të fundit dhe u karakterizuan me rritje. Norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare u rritën për 0.3 pikë përqindje, në 2.4 përqind, përderisa për ekonomitë familjare u rritën për 0.6 pikë përqindje, në 1.8 përqind (grafik 33).

### Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar deri në shtator të vitit 2022 realizoi fitim në vlerë prej 107.7 milionë euro, vlera më e lartë e regjistruar që nga themelimi i sektorit bankar për periudhat e njëjta. Ky rezultat financiar i atribuohet rritjes më të lartë të të hyrave, dhe rritjes relativisht më të ulët të shpenzimeve (grafik 34).


Gjithsej të hyrat arritën vlerën prej 270.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 13.6 përqind (14.8 përqind një vit më parë). Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 70.4 përqind të gjithsej të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga interesi, arkëtimet nga interesi në kredi kontribuan kryesisht në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit. Duhet theksuar që këtë vit, të hyrat nga interesi prej plasmanëve në bankat tjera janë rritur më theksueshëm krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, kategoria e të

Grafik 31. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare




Burimi: BQK.

Grafik 32. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Grafik 33. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.


hyrave nga jo interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, 9.1përqind nga 37.3 përqind në shtator 2021, dhe arritën në vlerën prej 70.1 milionë euro.

Shpenzimet u rritën për 10.0 përqind deri në shtator 2022 (rënie prej 1.5 përqind në shtator 2021) dhe arritën vlerën prej 162.8 milionë euro. Kontributin në këtë diferencë e kishte rritja prej 9.0 përqind e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative që kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit për 12.2 përqind (apo për 4.5 milionë euro). Kjo rritje sugjeron për rritjen e pagave të punonjësve në sektorin bankar, e cila mund të jetë korrigjim për inflacionin e rritur në vend. Poashtu, kategoria e shpenzimeve të jo-interesit shënoi rritje krahas rënies në vitin paraprak, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve për provizionet për humbjet e kredive (3.4 milionë euro rritje apo 36.6 përqind).

### Treguesit e shëndetit financiar


**Sektori bankar ndër vite ka arritur të siguroj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe të mbaj nivel të ulët të kredive jo performuese. Gjendja e kënaqshme e këtyre indikatorëve i jep përparësi sektorit në absorbimin e goditjeve nga pasiguritë e shkaktuara nga krizat gjeopolitike, rritja e inflacionit dhe ngadalësimi ekonomik.**

**Grafik 34. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar**




Burimi: BQK.

**Grafik 35. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione**




Burimi: BQK.

**Grafik 36. Treguesi i solvencës**



Burimi: BQK.

**Grafik 37. Treguesit e likuiditetit**



Burimi: BQK.

Kualiteti kreditor është përmirësuar kundrejt një viti më parë. Raporti i kredive joperformuese qëndroi në 2.1 përqind nga 2.4 përqind një vit më parë, dhe vlera e kredive jo-performuese zbriti për 0.1 përqind (nga rritja prej 1.9 përqind në shtator të vitit 2021). Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë qëndroi në 152.8 përqind nga 144.4 përqind (grafik 35).

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit zbriti në nivelin prej 15.8 përqind nga 17.9 përqind në shtator 2021, rezultat i rritjes së asetëve me peshë rreziku për shkak të rritjes së theksuar e kreditimit (grafik 36).

Raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra zbriti në nivel prej 35.1 përqind nga 39.9 përqind (grafik 37). Rënia e nivelit të likuiditetit krahasuar me një vit më parë është rezultat i rritjes së detyrimeve afatshkurtra prej 9.9 përqind dhe poashtu zvogëlimit të mjeteve likuide prej 3.2 përqind. Mjetet likuide janë zvogëluar si rrjedhojë e nivelit më të ulët të investimeve në letra me vlerë dhe depozita në banka dhe institucione tjera financiare, duke i orientuar këto mjete në kreditim. Poashtu raporti kredi/depozitë është ngritur në 80.4 përqind, rezultat i kreditimit të theksuar përgjatë këtij viti.

## Sektori pensional


**Sektori pensional shënoi ngadalësim të rritjes dhe rënie të kthimeve nga investimet krahasuar me një vit më parë, kryesisht si pasojë e dinamikave jo të favorshme në tregjet financiare ndërkombëtare.**

Me pjesëmarrjen e dytë më të lartë në gjithsej asetet e sistemit financiar, asetet e fondeve pensionale u rritën tutje me 4.2 përqind (7.1 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Vlera e asetëve pensionale arriti në 2.32 miliardë euro, nga të cilat 99.6 përqind përfaqësohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja), kurse pjesa e mbetur nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP-ja) (grafik 38).

Investimet nga FKPK-ja janë të fokusuar në tregun e jashtëm (70.6 përqind e portfolios investuese), kryesisht në fonde të përbashkëta në vlerë prej 1.6 miliardë euro (apo 67.2 përqind e gjithsej asetëve të FKPK-së), dhe pjesa tjetër e investimeve është e diversifikuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 562.0 milion euro apo 25.6 përqind e gjithsej portfolios investuese dhe certifikata të depozitit në sektorin bankar në vlerë prej 84.1 milionë euro (3.8 përqind e gjithsej investimeve). Struktura e portfolios investuese e FSKP-ës është e ngjashme me atë të FKPK-së. Pjesa më e madhe e mjeteve të Fondit Slloveno-Kosovar janë të investuara në sektorin e jashtëm, kryesisht në aksione (75.4 përqind e portfolios investuese), dhe në vlerë marginale në letra me vlerë (6.1 përqind e investimeve). Kurse, investimet brenda vendit janë kryesisht të fokusuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës që përbëjnë 18.1 përqind të gjithsej portfolios investuese.


Përderisa vlera e kontributeve të arkëtuara shënoi rritje në të dy fondet pensionale, kthimi në investime pësoi rënie të vlerës, të ndikuar nga luhajtjet në tregjet financiare. Rrethanat e pafavorshme të krijuara nga fillimi i luftës në Ukrainë dhe presionet inflacioniste në rritje shkaktuan destabilizim të tregjeve, duke ndikuar që performanca e fondeve pensionale të jetë e dobët në këtë tremujor.

Grafik 38. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

Grafik 39. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FSKP-ja për periudhën janar – shtator 2022 arriti në 442.6 mijë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.9 përqind, e ndikuar nga rritja e numrit të kontribut-dhënësve. Kurse, kthimi bruto nga investimet ishte në vlerë negative prej 895.3 mijë euro, ndërsa deri në shtator 2021 kthim ishte pozitiv në vlerë prej 715.7 mijë euro.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja deri në shtator 2022, me rritje vjetore prej 13.0 përqind, arriti vlerën në 177.1 milionë euro. Ndërsa investimet e FKPK-së pësuan rënie të vlerës, me kthim negativ prej 170.5 milionë euro (kthim pozitiv prej 132.7 milionë euro deri në shtator 2021) (grafik 39). Politika investuese e fondeve kërkon diversifikim të investimeve dhe synon kthim pozitiv në afat të gjatë, duke mbajtur njëkohësisht edhe një portofolio të ashtuquajtur ‘konzervativ’ mjetet e të cilit përfaqësohen nga kontribuesit që janë afër pensionimit, që me qëllim të mbrojtjes së vlerës së mjeteve, këto investohen në afat më të shkurtër dhe me kthim pozitiv të sigurt – siç janë investimet në letra me vlerë të Kosovës.

## Sektori i sigurimeve

**Sektori i sigurimeve shënoi nivel të përafërt të rritjes së asetëve me vitin paraprak, të favorizuar nga niveli i lartë i primeve të arkëtuara. Sidoqoftë, rritja e përshpejtuar e dëmeve të ndodhura rezultoi në një performancë financiare të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak.**


Sektori i sigurimeve përfaqëson 2.8 përqind të sistemit financiar në vend, pjesëmarrje relativisht e ngjashme përgjatë pesë viteve të fundit. Asetet e sektorit vazhduan trendin pozitiv të rritjes së viteve të fundit (grafik 40).

Kontributin më të lartë në rritjen e asetëve e kishte kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale me rritje vjetore prej 11.3 përqind (rritje për 12.0 milionë euro), në 117.9 milionë euro, pasuar nga rezervat teknike për risigurimin me rritje vjetore prej 27.9 përqind (rritje për 6.7 milionë euro), të cilat arritën vlerën prej 30.7 milionë euro. Ndërsa, në kuadër të detyrimeve rezervat teknike janë rritur për 10.3 përqind, apo për 15.7 milionë euro, në 167.9 milionë euro, si pasojë e rritjes së primeve të shkruara. Lëvizjet në rezervat teknike kishin kontributin kryesor në rritjen e gjithsej detyrimeve, konkretisht gjithsej detyrimet u rritën për 11.7 përqind deri në shtator 2022.

Vlera e primeve të shkruara deri në shtator 2022 arriti vlerën prej 98.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore të njëjtë me një vit më parë prej 13.1 përqind. Rritja e primeve të shkruara reflekton kryesisht rritjen e primeve të shkruara të përgjegjësishë ndaj palës së tretë, të cilat përbejnë 60.5 përqind të gjithsej primeve të shkruara jo-jetë.


Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve deri në shtator të vitit 2022 arriti vlerën prej 46.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.2 përqind (30.0 përqind një vit më parë) (grafik 41). Vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja

Grafik 40. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Grafik 41. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

ka shënuar rënie prej 11.8 përqind, kurse dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 4.8 përqind. Sektori i sigurimeve deri në shtator të vitit 2022 shënoi fitim në vlerë prej 3.1 milionë euro<sup>1</sup> (5.9 milion euro<sup>2</sup> në periudhën e njëjtë të një viti më parë). Fitimi më i ulët i realizuar gjatë kësaj periudhe krahasuar me atë të një viti më parë u ndikua nga rritja më e lartë e nivelit të dëmeve të ndodhura, saktësisht 22.0 përqind, se sa të hyrave neto nga primet me rritje vjetore prej 9.3 përqind. Gjithashtu, zbritja e fitimit të një siguruesi shtesë, si pasojë e tërheqjes së licencës, krahasuar me vitin paraprak ndikoi në një fitim më të ulët.


## Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar deri në shtator të vitit 2022 shënoi rritje të përshpejtuar të asetëve, kryesisht e ndikuar nga rritja e aktivitetit kreditor. Rezultati financiar rezultoi të jetë më i larti që nga konsolidimi i sektorit në periudhën përkatëse, konkretisht rritja e të hyrave ishte pothuajse dyfish më e lartë kundrejt rritjes së shpenzimeve. Mbështetja e aktivitetit kreditor u financua nga huazimet nga sektori i jashtëm (linjat kreditore). Indikatorët e shëndetit financiar gjithashtu tregojnë për stabilitet të sektorit në përgjithësi. Sidoqoftë, bazuar në rritjen e vazhdueshme të çmimeve, sektori mikrofinanciar pritet të përballë me kosto të rritura të financimit për shkak të rritjes së normave bazë të interesit si pjesë e politikës monetare të aplikuar nga një pjesë e madhe e vendeve të huaja për menaxhimin e inflacionit. Këto dinamika, mund të reflektohen në rritje të normave të interesit për kredi nga ky sektor. Andaj, në pritje për aktivitet më të dobët ekonomik, edhe pse e përcjellë me shumë pasiguri, mund të pritet edhe rënie e kërkesës për financim nga ky sektor.


### Asetet

Asetet e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje të përshpejtuar vjetore prej 11.7 përqind në shtator 2022, duke arritur vlerën prej 382.7 milionë euro në fund të periudhës (grafik 42). Në këtë rritje kontributin kryesor e kishte rritja e kreditimit, e cila shënoi një rritje dyshifrore në fund të shtatorit 2022. Aktiviteti kreditor i sektorit vazhdon të mbështetet nga huazimet (linjat kreditore) jashtë vendit të cilat u rritën për 9.1 përqind. Po ashtu, kontribut në rritjen e aktivitetit të sektorit kishte edhe rritja e nivelit të kapitalit, kryesisht përmes fitimit të bartur ndër vite dhe atij të realizuar deri në shtator 2022, komponentë që u rritën për 31.2 dhe 29.4 përqind, respektivisht.

Grafik 42. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Grafik 43. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare




<sup>1</sup> Larguar fitimi/humbja neto e kompanive të sigurimit Insig & Kosova e Re (të bartura pas marrjes së licencës)

<sup>2</sup> Larguar fitimi/humbja e kompanisë së sigurimit Insig (të bartur pas marrjes së licencës)

## Kreditë


Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar shënoi rritje të përshpejtuar duke iu afruar nivelit të rritjes së kreditimit në periudhën para pandemike.

**Grafik 44. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë**



Burimi: BQK.


**Grafik 45. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë**



Burimi: BQK.

Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rritje për 17.5 përqind në shtator 2022, përderisa stoku i tyre arriti në 271.7 milionë euro. Kreditimi u rrit për të dy segmentet ekonomik, korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare. Konkretisht, kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 14.8 përqind (rritje vjetore 12.8 përqind në shtator 2021), duke arritur vlerën 175.9 milionë euro në fund të shtatorit 2022 (grafik 43). Stoku i kredive ndaj korporatave jo financiare arriti vlerën prej 95.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 22.7 përqind (rritje për 11.9 përqind në shtator 2021). Në kuadër të kredive ndaj korporatave jo financiare, me rritje më të lartë të kreditimit u karakterizua sektori i shërbimeve, pasuar nga ai i bujqësisë dhe industrisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë (grafik 44 dhe 45).

**Grafik 46. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar**



Burimi: BQK.

## Lizingjet

Vlera e lizingjeve në fund të shtatorit 2022 arriti në 71.6 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 12.7 përqind, rritje e përafërt me atë të një viti më parë (grafik 46). Kontributin më të lartë në këtë rritje e kishte segmenti i korporatave jo financiare, që u rrit për 18.4 përqind, në 43.7 milionë euro. Kurse, lizingjet për ekonomitë familjare u rritën për 4.7 përqind krahasuar me një vit më parë dhe stoku i tyre arriti në 27.9 milionë euro.

## Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga ky sektor në shtator 2022 ishte 19.1 përqind, për 1.2 pikë përqindje më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 47). Sidoqoftë, për shkak të rritjes së normave bazë të interesit si pjesë e politikës monetare të aplikuar nga një pjesë e madhe e vendeve të huaja për menaxhimin e inflacionit sektori mikrofinanciar pritet të përballet me kosto të rritura të financimit, e të cilat mund të reflektohen në rritje të normave të interesit për kredi nga ky sektor.

Norma e interesit për kreditë e ekonomive familjare shënoi ulje për 0.9 pikë përqindje, në 20.9 përqind. Sipas llojit të kredive, për kreditë konsumuese, norma mesatare e interesit u ul për 1.6 pikë përqindje në 21.3 përqind. Kurse, kreditë hipotekare vazhdojnë të kenë normat më të ulëta të interesit, në mesatare prej 16.9 përqind në shtator 2022, një rënie vjetore prej 2.7 pikë përqindje.

Për korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar për 2.0 pikë përqindje, në 16.1 përqind. Sipas sektorëve ekonomik, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë e orientuara për sektorin e shërbimeve, të cilat kishin rënie prej 1.2 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak, sidoqoftë nëse i krahasojmë me tremujorin paraprak ka rritje prej 2.6 pikë përqindje të normës së interesit. Rënien më të madhe në normën e interesit e kishin normat e interesit për sektorin e industrisë prej 4.2 pikë përqindje. Përkundër uljes për 1.5 pikë përqindje, sektori i bujqësisë vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit (grafik 48).

### Performanca e sektorit mikrofinanciar


Sektori mikrofinanciar shënoi vlerë rekorde të fitimit deri në shtator të vitit 2022, kundrejt periudhës së njëjtë, qysh prej fillimit të operimit. Fitimi neto i sektorit ishte 13.5 milionë euro, për 3.1 milionë euro më shumë se gjatë periudhës së njëjtë të një viti më parë (grafik 49).

Të hyrat e sektorit deri në shtator 2022 shënuan vlerën prej 41.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.0 përqind. Rritja kryesisht i'u atribuua rritjes së të hyrave nga interesi në kredi dhe në lizingje. Gjithashtu, të hyrat nga jo interesi, kryesisht nga të ardhurat tjera operative, u karakterizuan me rritje.

Shpenzimet e sektorit shënuan rritje vjetore prej 8.9 përqind dhe arritën vlerën në 27.2 milionë euro në fund të shtatorit 2022. Rritja e shpenzimeve reflekton ecurinë e shpenzimeve nga jo interesi, përkatësisht atyre të personelit dhe administrative.


Si rrjedhojë e përmirësimit të performancës së sektorit, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave shënoi përmirësim duke u zvogëluar për 3.7 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, në nivel prej 65.6 përqind,

Grafik 47. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Grafik 48. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 49. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

\*Vlera për shtator 2022 është anualizuar



Performanca financiare e sektorit u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rritje, në 5.1 përqind dhe 17.3 përqind nga 4.6 përqind dhe 16.8 përqind, respektivisht sa ishin në shtator 2021.


Sa i përket treguesve të cilësisë së portfolios kreditore, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe kishin mbulueshmëri të lartë me provizione. Saktësisht, në shtator 2022 kreditë joperformuese zbritën në 2.1 përqind nga 2.9 përqind sa ishin në shtator 2021. Ndërsa, mbulueshmëria e KJP-ve me provizione arriti në 144.0 përqind nga 136.5 përqind në shtator të vitit të kaluar (grafik 50).

### Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës


**Emetimi i letrave me vlerë qeveritare deri në shtator 2022 ishte dukshëm më i ulët se në vitin paraprak, përderisa kërkesa për të investuar në këto letra me vlerë ka vazhduar të tejkalojë ofertën e qeverisë. Në linjë me rritjen e maturitetit të emetimeve, u rrit edhe norma mesatare e interesit, e cila ndër tjerash reflekton ngushtimin e raportit kërkesë/ofertë si dhe tendencës në nivel global për rritje të normave të interesit në instrumente financiare**

Deri në shtator të vitit 2022, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 183.8 milionë euro, për 35.8 përqind më pak se një vit më parë (grafik 51). Ndërsa, kërkesa për të investuar, në mungesë të alternativave investuese për diversifikim të mjeteve, vazhdimisht ka tejkaluar ofertën megjithëse ky raport ishte më i ulët se në vitin paraprak. Kërkesa për letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte për 1.33 herë më e lartë se sa shuma e ofruar nga Qeveria, ndërsa në vitin paraprak ishte për 1.60 herë më e lartë. Kjo rënie e raportit të kërkesës ndaj ofertës reflekton rënie të kërkesës për 46.4 përqind krahasuar me vitin paraprak si dhe të ofertës nga Qeveria apo shumës së shpallur që ishte më e ulët për 32.8 përqind. Fondet pensionale, si investuesit kryesor në letra me vlerë qeveritare, kanë rritur pjesëmarrjen në gjithsej borxhin e qeverisë në 50.0 përqind nga 45.0 përqind në shtator 2021, ndërsa bankat komerciale kanë zvogëluar pjesëmarrjen në 25.0 përqind nga 30.0 përqind në shtator 2021. Bankat mund të

Grafik 50. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore




Grafik 51. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 52. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

kenë ulur kërkesën për letra me vlerë në periudhën kur kreditimi ishte në nivel relativisht më të lartë. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë periudhës janar-shtator 2022 ishte 2.8 përqind, rritje për 0.7 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e normës së interesit reflekton ndër tjerash ngushtimin e raportit kërkesë/ofertë si dhe tendencës në nivel global për rritje të normave të interesit në instrumente financiare. Struktura e letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës ndër vite ka pësuar ndryshime graduale drejt emetimit të letrave me vlerë me afat më të gjatë maturimit. Në periudhën Janar-Shtator 2022, struktura u dominua nga fletë-obligaconet qeveritare me maturitet prej '5 viteve', për dallim nga viti paraprak ku mbizotëroni emetimi i fletë-obligacioneve me maturitet prej '3 viteve' (grafik 52).

### **Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 40, TM3 2022, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

### **Referencat:**

#### **BQK:**

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

#### **ASK:**

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

#### **Të tjera:**

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)

**Euribor:** Euribor Historical Rates: <http://ëëë.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

**ECB (BQE):** Economic Bulletin [Economic Bulletin Issue 6, 2022 \(europa.eu\)](http://europa.eu)

**FAOUN:** World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

**IMF (FMN):** World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

**World Bank:** Commodity Markets: [Commodity Markets \(worldbank.org\)](http://worldbank.org)